



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

Dep. \_\_\_\_\_ Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
Dep. 06/01 Br. Prot. 1205/23  
Nr. Fiq. \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_  
Er. Str. 03 Datum 12-06-2023  
Nr. Prap. \_\_\_\_\_

DATË/A:	09.06.2023
REFERENC-Ë:	DPKI-06-190/23
PËR/ZA/TO:	z. Feim HOXHA, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)
CC:	znj. Vjollca ALIU, Drejtoreshë e Departamentit për Trashëgimi Kulturore në MKRS  z. Ismet HAJRULLAHU, (ish) Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM)
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll BULESHKAJ, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Esad EJUPI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me shqyrtimin e konfliktit të interesit lidhur me pjesëmarrjen në një Komision Disiplinor të Drejtorit të Departamentit për Trashëgimi Kulturore në MKRS



Të nderuar ,

Rasti i raportuar nën dyshimin për konflikt të interesit lidhur me pjesëmarrjen e znj. V. Aliu, Drejtoreshë e Departamentit për Trashëgimi Kulturore në MKRS, në cilësinë e kryesueses në Komisionin Disiplinor ndaj Ismet Hajrullahu, (ish) Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform kompetencave të saj të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. pika 1.1.1. dhe 1.1.4., të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nxjerrë këtë:

### OPINION

Pjesëmarrja e znj. V. Aliu, Drejtoreshë e Departamentit për Trashëgimi Kulturore në MKRS, në cilësinë e kryesueses në Komisionin Disiplinor ndaj Ismet Hajrullahu, (ish) Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM), nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

## Ar sy e t i m

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), ku janë ngritur pretendime se: ‘[...] pjesëmarrja e znj. V. Aliu mbikëqyrëse e z. Ismet Hajrullahu, në Komisionin Disiplinor në cilësinë e kryesueses, është në kundërshtim me Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative [...], si dhe me Rregulloren QRK) Nr. 11/202020, për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik [...]’.

Pas pranimit të kërkesës si më lartë nga raportuesi i rastit, me qëllim të sqarimit të kësaj situate, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, fillimisht me shkresë zyrtare DPKI-06-01/775/23, ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MKRS-së informata, sqarime dhe dokumentacionin relevant lidhur me pretendimet e ngritura në këtë rast. Duke vepruar sipas kërkesës në fjalë, MKRS ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit informatat, sqarimet dhe dokumentacionin relevant (shkresa zyrtare: DPKI-06/775-01/23).

Pas trajtimit të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar si vijon:

Fillimisht, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

*“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.*

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

*“1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

*“Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”.*

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

*“Çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Pra, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* nën kushtet e ekzistencës së *interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm të tij* në një çështje të caktuar, ndërsa sa i përket pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit në rastin konkret, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jetë plotësuar njëri nga *dy kushtet kumulative*, siç është *interesi privat i zyrtarit* në çështjen konkrete.

Konkretisht, pretendimi i raportuesit të rastit se, *‘znj. Aliu nuk ka mundur të jetë as objektive dhe as e paanshme, duke pasur interes personal të drejtpërdrejtë, [...], duke ndikuar në marrjen e një vendimi të kundërligjshëm ndaj tij, me të vetmin qëllim që të shmang ndonjë procedurë disiplinore eventuale të iniciuar ndaj saj, si përgjegjëse për të gjitha çështjet dhe politikat e trashëgimisë kulturore në MKRS*, është i mbështetur në supozime dhe rrethana subjektive, prandaj Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në rastin konkret nuk ka gjetur se znj. Aliu të ketë pasur interes personal (privat) në vendimmarrjen në fjalë.

Prandaj, në rastet kur ekziston vendimmarrja, por nuk plotësohet kushti tjetër kumulativ i domosdoshëm që është interesi privat i zyrtarit, përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në këtë mënyrë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, vendosi si në dispozitiv të këtij opinioni.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, rastin në fjalë e ka trajtuar në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që i jep Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligji (nr. 08/L-017), për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, prandaj nuk është lëshuar në trajtimin e pretendimeve tjera që nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit, përkatësisht janë jashtë kompetencave dhe mandatit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Gjithashtu, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pretendimet e ngritura në këtë rast për konflikt të interesit i ka trajtuar ekskluzivisht sipas këndvështrimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe nuk është lëshuar në trajtimin e aspekteve tjera sa i përket interpretimit dhe/ose zbatimit (të drejtë ose jo) të Ligjeve apo rregulloreve tjera relevante, e as veprimeve tjera procedurale në këtë çështje e të cilat bien në kompetencë të organeve tjera relevante.

**Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit**